



International  
Union  
of Notaries

## DEONTOLOGJIA DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT TË NOTERIVE

### HYRJE

Dokumenti i bashkëngjitur bazohet në/dhe përditëson "Parimet themelore të sistemit notarial të tipit Latin", të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare të Unionit Ndërkombëtar të Noterive të tipit Latin (UINL) në Romë (Itali), më datë 8 nëntor 2005, si dhe "Parimet e Deontologjisë Noteriale", të miratuara në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare të UINL në Meksikë, më datë 17 tetor 2004.

Kjo i përgjigjet nevojës së ndjerë nga organet e ndryshme të UINL dhe kërkesës së disa autoritetave notoriale dhe jo notoriale sa i përket organizimit dhe veprimtarisë së noterëve.

Ky dokument i shkruar është në formën e një "Ligji Uniform", që mund të shërbejë si model për të frymëzuar noterët në organizimin dhe ushtrimin e funksionit të tyre publik, por edhe në identifikimin dhe zbatimin e parimeve dhe rregullave deontologjike.

Këto dispozita janë universale dhe janë menduar që të zbatohen në të gjitha Noteritë Anëtare të UINL dhe në Noteritë tjera të cilat dëshirojnë t'i bashkohen Unionit.

Ato propozojnë nivele të ndryshme të zbatimit:

- Tek Kapitulli i Parë (Parimet dhe Organizimi i Noterive): dispozitat të cilat përbëjnë esencën e Noterive.
- Tek Kapitulli i Dytë (Marrëdhëniet e Noterive me shtetin): dispozitat themeluese të kuadrit të Noterive brenda organizimit gjyqësor të vendit dhe sistemit të saj juridik.
- Tek Kapitulli i Tretë dhe i Katërt: rregullat e caktuara që janë thelbësore për formën e ekzistimit të Noterive, siç është detyra për t'u bërë anëtar i një organi kolegjial, sistemi i inspektiveve dhe auditove notoriale, përgjegjësitë notoriale, konfidencialiteti, zgjedhja e lirë e noterit, sistemi i papajtueshmërisë dhe rregullat tjera, të tillë si solidariteti financiar, trajnimet e vazhdueshme, ndihma për noterët e sëmurë ose që mungojnë, të cilat organizohen në forma të ndryshme prej një Noterie në tjetrën.
- Dhe në fund, tek Kapitulli i Pestë: dispozitat lidhur me shkeljet dhe llojet e sanksioneve të zbatueshme që do të duhet të miratohen në secilin vend, në përputhje me ushtrimin e funksionit të noterit.

Si rezultat, ky dokument është një lloj "modeli" i hapur, i përbërë nga një sërë rregullash ligjore dhe etike (shpesh vështirë të dallueshme), të cilat synojnë sigurimin e disa udhëzimeve për Noteritë që janë pjesë e Unionit Ndërkombëtar të Noterive.

## PARATHËNIE

Deontologjia është një element thelbësor dhe i domosdoshëm në ushtrimin e funksionit notarial. Pa të, është e pamundur që të përmbushim funksionin tonë si duhet, pasi që profesioni notarial dallohet me përbajtje të rëndësishme etike. Kjo është arsyja pse detyra jonë është që të përqendrohemë në/dhe të shpërndajmë brenda noterive ndërkombëtare, sa më shumë të jetë e mundur, rregullat deontologjike për praktikën tonë profesionale që forcojnë vlerën e saj sociale, në kërkim të përsosjes.

Aktiviteti i noterëve është unik. Detyrë e tyre shumë delikate është sigurimi i sigurisë juridike dhe të vërtetës, të cilat janë thelbësore për shoqërinë. Prandaj, noteria është një institucion që është absolutisht i dobishëm dhe i nevojshëm për shoqërinë.

Në funksionin e tij parandalues, veprimitaria e noterisë lejon sigurinë juridike dhe sigurinë në përgjithësi, dhe ushtrohet në mënyrë të quartë duke marrë parasysh etikën e duhur. Vlerat e sigurisë juridike dhe të sigurisë janë instrumente për të arritur qëllimin final të ligjit: Drejtësinë. Dhe kjo është arsy se pse etika është një kriter kryesorë. Ajo është baza e saj, rrënja e saj dhe forca e legjimititetit të saj. Megjithatë, noterët, si çdo profesionist tjetër, mund të bëjnë gabime ose lëshime, edhe pse këto nuk duhet të ndodhin kurrë. Prandaj, është e rëndësishme që të hartohet një Kod i Deontologjisë që përcakton minimumin dhe rregullat themelore për të rregulluar veprimet e noterëve.

Ky Kod përcakton vlerat themelore të veprimitarisë së noterëve të cilat kanë qenë, janë dhe do të mbeten thelbësore për veprimet e tyre. Ato janë parime të studiuara dhe të shpërndara për më shumë se gjashtëdhjetë vjet me UINL, të cilat përbëjnë çështjet që kanë ndikuar në realitetin shoqëror dhe që kanë të bëjnë me veprimin e noterëve në fushën e ekologjisë, teknologjisë informative, pastrimit të parave, mbrojtjes së të dhënavë personale, kulturës së ligjshmërisë dhe natyrisht, në dimensionin social të noterisë.

Nëpërmjet sjelljes së tyre etike të patëmetë, noterët duhet të zhvillojnë funksionet publike dhe sociale të nevojshme për të ofruar të mirat e drejtësisë së shëndoshë parandaluese për shoqërinë.

Ky "Ligi Uniform" mund të konsiderohet si një "Kod model" nga shtetet anëtare të UINL. Është një instrument që ndihmon në forcimin e respektit përvlerat juridike të veprimitarisë noteriale.

Shkelja e rregullave etike duhet të dënohet dhe u mbetet Odave kombëtare që të vendosin sanksionet dhe procedurat e lidhura me zbatimin; Odat kombëtare duhet po ashtu të vendosin procedura praktike për të siguruar përputhshmëri të plotë me detyrat deontologjike të përcaktuara në këtë Kod.

Në këtë drejtim, vlen të ritheksojmë se rregullat deontologjike janë si standarde juridike dhe për këtë arsyje janë pjesë e sistemit juridik, pasi ato karakterizohen me përbajtjen e tyre etike dhe marrëdhëniet e tyre të drejtpërdrejta me ligjet kushtetuese dhe të zakonshme të secilit shtet anëtar.

Pajtueshmëria me Kodin e Deontologjisë e ruan natyrën origjinale të profesionit të noterëve dhe luan një rol të mbrojtjes dhe referimit që ndihmon në përcaktimin e veprimeve të tyre dhe për të konsoliduar punën e tyre. Noterët duhet të miratojnë dhe të mbështesin atë dhe ta bëjë atë një mënyrë të jetesës, duke qenë, duke vepruar dhe arsyetuar, pasi që e tashmja dhe e ardhmja e Noterisë varet nga përputhja me këtë Kod.

## PREZANTIM

Që nga themelimi i saj në vitin 1948, Unioni Ndërkombëtar i Noterëve (UINL) ka krijuar një numër të vlerave dhe parimeve që kanë ndihmuar në përshkrimin e Noterisë si një institucion që është pjesë e sistemit juridik të shtetit dhe që përcakton se çfarë duhet të bëjnë noterët dhe se si duhet të veprojnë ata.

Këto vlera dhe parime, të finalizuara gjatë Kongreseve të ndryshme të Unionit, janë sistemuar në "Parimet themelore të Sistemit Noterial të tipit Latin" dhe "Parimet e Deontologjisë Noteriale" që janë tekstet themelore strukturore të UINL dhe kulturës së saj.

Megjithatë, meqenëse dokumentet e më parme janë programatike, është e nevojshme që ato të zhvillohen në një bazë të qëndrueshmët të ligjeve, për të krijuar një ligj uniform që përcakton dhe detajon atë dhe që mund të përdoret si një mjet pune nga ana e organeve të ndryshme të UINL në funksion të përhapjes dhe sqarimit të tipareve të funksionit notarial në të gjithë botën.

Ky Ligj model duhet të shërbejë si model legjislativ për ato vende që dëshirojnë të fusin noterinë e tipit Latin në sistemin e tyre ligjore dhe si referencë apo si mjet për përditësim në ato vende që tashmë kanë një bazë ligjore të kësaj natyre.

Me kërkesë të Kryetarit të Unionit, Komisioni i Deontologjisë Noteriale ka hartuar këtë Kod, duke shtuar vlerat etike që dalin nga nevojat e shoqërive tona të reja, gjithëpërfshirëse dhe globale (të tilla si shërbimi i noterëve dhe vlerat e shtuara të funksionit të tyre në ruajtjen e të drejtave të njeriut, në mbrojtjen e konsumatorëve dhe palëve që kërkojnë më shumë informacione, në zhvillimin e qëndrueshmë ekonomik, të mjedisit, transparencës, parandalimit të pastrimit të parave dhe marrëdhëniet fleksibile ligjore ndërkombëtare), në vlerat tradicionale të noterëve (të tilla si ligjshmërinë, paanshmërinë, pavarësinë, sigurinë preventive ligjore, arsimimin e vazdueshmë dhe trajnimin, fshehtësinë profesionale dhe konfidencialitetin). Të gjitha këto vlera dhe nevoja janë shtuar në detyrat e natyrshme në profesion, pasi ky është një profesion që jeton në kontakt të drejtpërdrejtë me shoqërinë që i shërben.

Nëpërmjet një Kodi të përfaqësuar nga ky "Ligj uniform", vlerat e mësipërme etike, të miratuara nga të gjitha Noteritë në botë, të përfaqësuara brenda UINL-së, marrin vlerat e rregullave deontologjike të profesionit dhe si rezultat bëhen rregulla obligative dhe të detyrueshme për noterët.

Qëllimi i këtij Kodi është të organizojë ushtrimin e profesionit të noterit në një mënyrë pozitive, duke grupuar vlerat etike dhe duke u dhënë atyre karakterin e rregullave deontologjike në të cilat ata përcaktojnë jo vetëm mënyrën e të qenit (etika) si veprim i noterëve, por edhe mënyra e tyre "se si duhet jenë" (deontologjia noteriale), dhe detyrat profesionale që noterët duhet të përmbushin. Kjo është arsyaja se pse ky Kod propozon qasje pozitive dhe përcakton sanksionet që do të zbatohen në rast të shkeljes së rregullave të tij.

Dokumenti është i ndarë në pesë kapituj, duke pasuar kështu sistemin tradicional të marrjes me këtë çështje në kodet e ndryshme kombëtare të deontologjisë.

Kapitulli i Parë "Parimet dhe Organizimi i Noterive" grumbullon parimet dhe

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*  
rregullat e organizimit të profesionit, të cilat më pas trajtohen si rregulla të detyrueshme deontologjike, për të theksuar se ato duhet të jenë të zbatueshme dhe të detyrueshme.

Kapitulli i Dytë, "Marrëdhëniet e noterisë me shtetin", rregullon detyrat që rrjedhin nga natyra e dyfishtë e "Zyrtarit publik apo zyrtarit" dhe "Profesionistit liberal juridik" të noterisë.

Kapitulli i Tretë, "Marrëdhëniet e noterëve me odat ose asociacionet e profesionistëve", ka të bëjë me marrëdhëniet vertikale të Noterëve, me sistemin organik të organizimit të noterive, përfshirjen e organeve të tij në administratën shtetërore të drejtësisë, sistemin e përdorur për të caktuar noterët, pjesëmarrjen e tyre në organizata notoriale, përgjegjësitë e tyre dhe me solidaritetin koorporativ.

Kapitulli i Katërt, "Marrëdhëniet e noterëve me noterët tjerë, punonjësit dhe përdoruesit e shërbimeve", ka të bëjë me marrëdhëniet horizontale të noterëve, me vlerat që duhet pasur në aktivitetet e tyre të përditshme me përdoruesit e shërbimit ose me çfarëdo personi tjetër që kërkon shërbimet e tyre, me noteritë tjetra dhe punonjësit dhe ndihmësit e tyre.

Dhe në fund, Kapitulli i Pestë, "Sistemi i papajtueshmërisë, ndalimeve dhe sanksioneve", përmbyllë kodin me një përbledhje të mandateve të përfshira në kapitujt e mëparshëm. Ai liston rastet e mos-përputhjes me rregullat e detyrueshme, duke u pasuar me sanksione dhe juridikSIONIN për zbatimin e tyre.

Në pak fjalë, ky Ligj Model hartohet si dokument ligjor i zbatueshëm dhe tematik i rregullave të organizimit dhe rregulloreve deontologjike, duke theksuar vlerën e shtuar të shërbimit notarial të ofruar për shoqërinë globale e cila shërben si instrument i sigurisë juridike, drejtësisë dhe i paqes sociale.

## KAPITULLI I

### PARIMET DHE RREGULLAT E ORGANIZIMIT PËR NOTERIT

#### NENI 1.- QËLLIMI DHE NATYRA E KODIT - ZBATIMI

Dispozitat e përfshira në këtë Kod janë një sistem ligjor model i deontologjisë për Noteritë anëtare në UINL dhe duhet të transponohen në ligjet e ndryshme kombëtare noteriale, pasi që ato përcaktojnë, specifikojnë dhe shpjegojnë "Parimet e Deontologjisë Noteriale" të UINL-së dhe dokumentet e ndryshme të Unionit mbi këtë temë, të miratuar nga Mbledhja e Përgjithshme të Noterive anëtare të kësaj organizate joqeveritare në "Meksiko Siti" më 17 tetor 2004.

Zbatimi i dispozitave të këtij Kodi duhet të jenë i detyrueshëm për secilin prej shteteve anëtare të UINL, duke i përfshirë ato në ligje dhe rregullore mbi noteritë ose duke miratuar ligje për Deontologjinë Noteriale.

Dispozitat e përfshira në këtë Kod dhe që nuk janë transpozuar në ligjet kombëtare noteriale do të jenë të zbatueshme si rregullat deontologjike nga Odat ose shoqatat përkatëse profesionale, pasi që ato shprehin përbajtjen deontologjike të profesionit të noterit.

#### NENI 2.- VEPRIMTARIA E RREGULLUAR

Veprimtaria e Noterisë rregullohet dhe i nënshtronhet ligjeve dhe rregulloreve kombëtare mbi këtë çështje.

Ky Kod përcakton dispozitat e zbatueshme për noterët dhe do të zbatohet, në mënyrë ndihmëse, për rregullat kombëtare të Noterive anëtare në UINL.

Noterive do t'i kërkohet që të respektojnë dhe sigurojnë pajtueshmërinë me rregullat e noterisë që rregullojnë profesionet dhe veprimtarinë e tyre sipas njohurive të tyre më të mira dhe të drejta.

#### NENI 3.- ORGANIZIMI I NOTERIVE

Prandaj, noteri është si zyrtarë publik ashtu dhe praktikues i ligjit

##### 3.1.-Zyrtarë publik.

Noteri është zyrtar publik të cilit shteti i ka deleguar kompetencën e tij duke i lejuar atij që të vërtetoj autenticitetin e dokumenteve që ai i harthon, për të siguruar ruajtjen e tyre, për t'u dhënë atyre fuqi dëshmuese dhe për t'i bërë ato të zbatueshme.

##### 3.2.- Praktikues i ligjit

Përveç të qenit një zyrtar publik, Noteri është gjithashtu një jurist që ushtron funksionin e tij publik në kuadër të një profesioni të pavarur, profesion të rregulluar.

##### 3.3.- Oda e Përbashkët Kombëtare ose Shoqata e Noterëve të varura nga Ministria e Drejtësisë.

Noteria formohet nga të gjithë noterët e një vendi, të grupuar brenda një Ode të përbashkët ose organizate kombëtare, të pavarur nga shteti por që i përbahet parimeve të drejtës publike dhe e njohur nga ligji. Sipas rrethanave, ky institucion

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*  
duhet të grupoj Odat e ndryshme lokale brenda vendit dhe të vendoset nën mbrojtjen e  
Ministrisë së Drejtësisë.

## **NENI 4.-INTERESI I PËRGJITHSHËM I VEPRIMTARISË SË NOTERISË DHE VLERA SHOQËRORE E NOTERISË**

Si përfaqësues të një pjese të sovranitetit shtetëror, noterët duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre duke kontrolluar ligjshmérinë e akteve dhe çështjeve me të cilat merren në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe të përgjegjshme dhe rrjedhimisht t'i vërtetojnë ato. Përmes përfshirjes së tyre në shërbim të interesit të përgjithshëm dhe sigurisë ligjore parandaluese, noterët duhet të bëjnë të mundur shmangien e mosmarrëveshje dhe t'i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe paqes sociale.

Veprimtaritë e noterëve nuk mund të delegohen dhe noterët janë të obliguar që të hartojnë akte, duke përjashtuar lëndët me refuzim të bazuar të shpjeguar më poshtë.

## **NENI 5.- KUSHTET PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT NOTERIAL**

### **5.1.- Kualifikimet profesionale dhe personale**

Noteria si një institucion dhe noterët si profesionistë, duhet të kenë kualifikimet maksimale ligjore në vendet e tyre përkatëse në mënyrë që të ushtrojnë punën e tyre juridike, të kenë kaluar provimet për të fituar qasje në profesion si dhe të kenë njojuritë e nevojshme ligjore për të kontrolluar në mënyrë efektive dhe me saktësi ligjshmérinë e akteve dhe dokumenteve që ata hartojnë.

Noterët duhet të mbajnë një qëndrim personal etik gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duke u përmbajtur nga ndonjë sjellje që mund të rezultojë me humbjen e besimit të qytetarëve në institucionin e noterisë ose që është në kundërshtim me dinjitetin e noterisë.

### **5.2.- Ligjshmëria**

Përfshirja e noterëve duhet të jetë në përputhje me ligjshmérinë dhe të shhang anashkalimet mashtruese të ligjit dhe dëmtimit të personave; aktet ose dokumentet që ata hartojnë ose në të cilat janë përfshirë, do të përfitojnë nga prezumimi i pajtueshmërisë me Ligjin.

Noterët duhet të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë korrekte dhe me kompetencë gjatë zbatimit të ligjit dhe në të gjitha manifestimet e veprimtarisë së tyre profesionale, duke kërkuar formën ligjore që i përshtatet më së miri interesave publike dhe private, për të cilat është kërkuar përfshirja e tyre.

### **5.3.- Paanshmëria**

Noterët, si "Palë të Treta të besuara", duhet të jenë të paanshëm në punën e tyre kundrejt palëve dhe çdo pale tjeter të tretë të interesuar, me qëllim të ruajtjes së sigurisë juridike.

Paanshmëria e Noterëve duhet të jetë pozitive, duke mos e konsideruar fare mundësinë e mungesës ose çekuilibrit të informacioneve mes palëve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë palëve në kontratë që më së shumti e kërkojnë ndihmën e tyre, dhe duke ofruar këshillat e tyre si profesionistë të kualifikuar.

Noterët nuk mund të hartojë dokumente publike që përfshijnë dispozita që mund të favorizojnë ata drejtpërdrejt ose tërthorazi.

#### 5.4.- Pavarësia

Noterët duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur kundrejt palëve dhe Administratës, por pa dëmtuar ndonjëherë këtë të fundit.

Noterët duhet të shmangin ndikimin dhe diskriminimin e palëve.

#### 5.5.- Respektimi i të drejtave themelore

Noterët duhet të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e njeriut, mjedisin (pastërtinë e ujit dhe ajrit, si kushte themelore për jetën), drejtësinë, lirinë, të vërtetën, ndershmérinë, besueshmérinë dhe janë të detyruar të mbajnë sekretin profesional.

Noterët duhet të refuzojnë korruptionin, korruptimin, marrëveshjet e fshehta dhe veprimet tjera që dëmtojnë personat dhe zhvillimin ekonomik, si dhe çdo akt i cili, megjithëse në përputhje me ligjin, është në kundërshtim me fryshten e tyre, ose çdo akt që është haptazi i dëmshëm për palët.

#### 5.6.- Gatishmëria, zelli dhe përgjegjësia.

Noterët duhet të janë të gatshëm të kryejnë detyrat e natyrshme në shërbimin e tyre, të veprojnë me kujdesin e një profesionisti të shkëlqyer dhe të kërkojnë rrënjëzimin social në vendet ku ata ushtrojnë funksionin e tyre.

Noterët janë përgjegjës për çfarëdo dëmi dhe dëmtimi që mund t'i atribuohet atyre (nëpërmjet veprimeve të tyre ose nëpërmjet akteve që hartojnë, e që janë në kundërshtim me ligjin ose kujdesin e një profesionisti të përsosur), dhe një përgjegjësi e tillë duhet të jetë e garantuar.

#### 5.7.- Autonomia profesionale

Noterët janë autonom në ushtrimin e funksionit të tyre, pa shkelur anëtarësimin e tyre në Oda si dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të funksionit të tyre nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

#### 5.8.- Mospërputhshmëria

Noterët duhet të refuzojnë përfshirjen në rastet e mospërputhshmërisë së parashikuar në tekstin e mëtejshmë.

### **KAPITULLI II**

#### **MARRËDHËNIET E NOTERIVE ME SHTETIN**

#### **NENI 6.- VARËSIA NDAJ MINISTRISË SË DREJTËSISË. ODAT OSE SHOQATAT PROFESIONALE**

Noterët ushtrojnë funksionin e tyre nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe janë të lidhur me odat ose shoqatat profesionale të noterëve.

Odat ose shoqatat profesionale të noterëve (lokale apo kombëtare) janë subjekte ligjore të së drejtës publike të afta që të marrin masa për të arritur qëllimet e tyre. Ata janë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë.

## **NENI 7.- ODAT OSE SHOQATAT PROFESIONALE TË NOTERËVE**

Pa cenuar fushëveprimin e tyre të përcaktuara nga ligjet notariale, odat apo shoqatat profesionale të noterëve janë përgjegjëse për organizimin e ushtrimit të profesionit notarial, duke e përfaqësuar atë, mbështetur interesat e tij si dhe duke realizuar funksionin social të noterive.

Në përfaqësimin e profesionit notarial, odat apo shoqatat e noterëve do të duhet të përbushin dhe të sigurojnë përbushjen e dispozitave të këtij Kodi, duke mbikëqyrur ushtrimin e duhur dhe ruajtjen e funksionit notarial, si mes noterëve ashtu dhe me palët e treta.

Odat vendore apo shoqatat profesionale do të grupohen në një odë ose shoqatë të vetme në nivel kombëtar.

Organet drejtuese të odave apo shoqatave do të zgjidhen në mënyrë demokratike nga noterët që janë anëtarë në asamblenë e përgjithshme.

Odat ose shoqatat janë në krye të inspektimeve dhe mbikëqyrjes së noterëve anëtarë dhe janë kompetent në çështjet që lidhen me disiplinën dhe sanksionet, siç është përcaktuar në tekstin e mëtejmë.

Anëtarësia e odës ose shoqatës notariale është kusht thelbësor për ushtrimin e funksionit notarial.

Odat apo shoqatat e noterëve do të financohen nëpërmjet tarifave të anëtarësisë së noterëve anëtarë, fitimet dhe të ardhurat e siguruara nga pronat e tyre, si dhe aktivitetet dhe shërbimet e kryera në përputhje me statutet e tyre.

## **NENI 8.- DELEGIMI I AUTORITETIT TË SHTETIT. SHËRBIMI PUBLIK**

Noterët i detyrohen besnikëri shtetit i cili i ka deleguar atyre autoritetin publik, si dhe kërkohet nga ana e noterëve që të ushtrojnë këtë detyrë në fryshtë e shërbimit dhe dinjitetit.

Si zyrtarë publik, noterët duhet të ushtrojnë misionin e tyre sa herë që kërkohet, duke përdorur të gjitha materialet dhe burimet njerëzore të nevojshme për përbushjen e shërbimit publik që përfshinë puna e tyre.

Ata duhet të përbushin funkcionin e tyre publik me integritet, gatishmëri dhe kujdes si dhe të përbahen nga çdo sjellje që është në kundërshtim me dinjitetin e pozitës së tyre të zyrtarit apo zyrtarit publik ose që mund të favorizojë ata drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Po të njëjtat detyra vleinë edhe për punonjësit e noterëve dhe përgjegjësia për punën e tyre i atribuohet noterëve.

Noterët mund të largohen nga misioni i tyre vetëm në rastet e parashikuara me ligj dhe pasi të kenë garantuar se shërbimi notarial në rrethet e tyre do të vazhdojë të jetë i siguruar.

## **NENI 9.- BASHKËPUNIMI ME GJYQËSORIN**

Si praktikues të ligjit në çështjet jo-kontestimore dhe të deleguar të autoritetit

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*

shtetëror, noterët dhe odat ose shoqatat profesionale që i përfaqësojnë ata do të bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore në përbushjen e funksionit të tyre publik dhe në kuadër të kompetencave të caktuara nga shteti në kuadër të këtij bashkëpunimi, me qëllim të përmirësimit të zhvillimit dhe zbatimit të drejtësisë dhe paqes sociale.

## **NENI 10.- BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA SHTETËRORE, AGJENCITË DHE ORGANIZATAT E NDRYSHME**

Pa cenuar detyrën e tyre të fshehtësisë profesionale, noterët do të bashkëpunojnë me institucionet dhe agjencitë shtetërore për funksionet e deleguara dhe në kuadër të kornizës së marrëdhënieve zyrtare të lidhura me fushëveprimin e tyre.

Gjithashtu, ata do të bashkëpunojë me institucionet dhe agjencitë e tjera publike dhe private, kur një gjë e tillë kërkohet si delegatë të autoritetit publik, në pajtim me detyrat e lidhura me funksionin e tyre, dhe duke u siguruar se edhe homologët e tyre janë në pajtim me këto detyra.

## **NENI 11. - ZYRA PUBLIKE**

Zyrat noteriale organizohen në mënyrë të pavarur nga noterët dhe janë nën përgjegjësinë e tyre. Ata do të përfitojnë nga pacuneshmëria që kanë si zyrtar publik.

Ata do të janë nën hierarkinë e odave ose shoqatave profesionale të noterëve nga të cilat varen. Kjo e fundit do të jetë në krye të menaxhimit të përgjithshëm të shërbimit notarial, inspektiveve dhe mbikëqyrjes. Gjithashtu, ata vendosen nën mbrojtjen e gjykatave.

Registrat notarial, dokumentet dhe arkivat mbahen nga noterët dhe janë subjekt i konfidencialitetit dhe fshehtësisë profesionale.

Pa cenuar protokollin e fshehtësisë dhe konfidencialitetit të zyrës së noterisë, protokollin e noterisë, protokollet noteriale, arkivat si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre, noterët duhet të mundësojnë qasjen e plotë në dokumentet e mëposhtme nga autoritetet më të larta të odave apo shoqatave të cilëve u takojnë, në mënyrë që të njëtin të mund të ekzaminohen, inspektohen dhe kontrollohen.

## **NENI 12.- MJETET TEKNOLOGJIKE**

Nga noterët kërkohet pajisja e zyrave të tyre me mjetet më të avancuara teknologjike dhe të paktën me materialet e nevojshme për të ushtruar detyrën e tyre, në pajtim me organizimin e Shërbimit Shtetëror dhe Publik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

## **NENI 13.- KOMPETENCA**

Kompetenca e noterëve përbëhet nga akte jashtë-gjyqësore dhe marrëveshje, akte të juridiksimit vullnetar dhe çfarëdo vepre ose marrëveshje tjetër duhet regjistruar në regjistrat publik dhe ato për të cilat shteti ka deleguar autoritetin e tij.

Kompetenca territoriale ose personale e noterëve do të përcaktohet me ligj.

## **NENI 14.- EMËRIMI DHE MANDATI I PUNËS SË NOTERËVE**

Duke marrë parasysh pavarësinë dhe paanshmërinë që është tipike për funksionin e tyre, sistemi për emërimin e noterëve duhet të mbetet në kompetencë profesionale

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*  
bazuar në kriteret objektive.

Noterët duhet të kenë arritur nivelin më të lartë teknik të kërkuar nga shteti për të ushtruar profesionet ligjore.

Mandati do të jetë i pakufizuar dhe përfundon vetëm në rast të daljes në pension sipas kushteve të përcaktuara me ligj, paaftësisë ose pazotësisë, apo dëbimit të shpallur me një vendimi të plotfuqishëm të gjykatës.

### **NENI 15.- TRAJNIMI PROFESIONAL. TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS**

Noterët duhet të kryejnë veprimtarinë e tyre profesionale me kompetencë dhe me trajnime adekuate, sidomos për funksionet kyçë siç janë ato të këshillimit, konsultimit, interpretimit dhe zbatimit të ligjtit. Si rezultat i kësaj, nga noterët kërcohët që të përditësojnë njohurit e tyre si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Me qëllim të përbushjes së detyrave të tyre të mësuarit gjatë gjithë jetës, nga ata do të kërcohët ndjekja e udhëzimeve të siguruara nga odat ose shoqatat profesionale të tyre.

Detyra e të mësuarit gjatë gjithë jetës përfshinë edhe punonjësit e noterëve, nga të cilët kërcohët inkurajimi dhe mbikëqyrja e të mësuarit.

### **NENI 16.- DETYRA E PERFORMANCES. MOHIMI I SHËRBIMIT**

Funksioni notarial është personal dhe nuk mund të delegohet. Ushtrimi i këtij funksioni është i detyrueshëm.

Në cilësinë e zyrtarëve publikë, noterët mund të refuzojnë ofrimin e shërbimeve të tyre vetëm në rastet e mëposhtme:

1.- Kur një veprim është në kundërshtim me ligjin ose rendin publik ose vë në lajthim palët e treta.

2.- Kur një veprim nënkupton shhangjen mashtruese të ligjeve, palëve të treta ose autoriteteve publike.

3.- Në rastet e detyrave të papajtueshmërisë të përshkruar në vijim.

4.- Kur një veprim nuk bie brenda kompetencave të tyre.

5.- Kur një veprim është në kundërshtim me dinjitetin që pritet nga një zyrtar publik.

Refuzimi i një noteri që të ofroj shërbimet e tij nuk mund të jetë subjekt i peticionit të parashtruar para një nga organet e noterive.

Noterët nuk mund të refuzojnë përbushjen e funksionit të tyre në bazë të ndërgjegjes, në qoftë se vepra që kërkon përfshirjen e tyre është në përputhje me ligjet e shtetit.

Zyra noteriale duhet të jetë e hapur gjatë orarit të zakonshëm të punës dhe të ketë noterin dhe stafin e nevojshëm për të ofruar një shërbim publik.

### **NENI 17.- LIGJSHMËRIA. KORRUPSIONI. SHPËRLARJA E PARAVE**

Noterët duhet që gjithmonë të sillen me etikë dhe në përputhje me Ligjin.

Noterët duhet të refuzojnë korrupsionin, bindjen me dhunë, praktikat e pandershme, shpëlarjen e parave, evazionin tatum, terrorizmin dhe çfarëdo aktiviteti tjeter kriminal, siç është ushtrimi i ligjit në mënyrë antisociale.

Në fushën e shpëlarjes së parave, noterët ofrojnë bashkëpunimin e tyre si dhe të gjitha informatat e nevojshme për autoritetet kompetente, në përputhje me ligjet e shtetit, por nuk obligohen të angazhohen në hetimet që bien brenda juridiksionit të agjencive të zbatimit të ligjit ose të autoriteteve gjyqësore. Ky bashkëpunim do të rregullohet nga parime objektive dhe kriteret e përcaktuara me ligj, në bashkëpunim me organet qendrore të noterive.

Njoftimi i autoriteteve rrëth ndonjë transaksi të dyshimtë për përfshirje në shpëlarje të parave nuk do të konsiderohet shkelje e fshehtësisë profesionale, pasi që është në interes të përgjithshëm dhe e mira e përgjithshme mbizotëron.

#### **NENI 18.- TË DREJTAT E NJERIUT. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM. E MIRA E PËRGJITHSHME**

Gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, noterët duhet të promovojnë të drejtat e njeriut dhe në veçanti të respektojnë të drejtën e jetës, ushqimit dhe mjedisit (ujin dhe ajrin e pastër) si dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë bazuar në solidaritet.

Noterët duhet të respektojnë të drejtat e popullsive lokale, duke i ndihmuar ata në forcimin dhe krijimin e strukturave të tyre ligjore, ekonomike, kulturore dhe sociale.

Noterët duhet të promovojë lirinë, drejtësinë dhe të vërtetën me anë të zbatimit të ligjit, dhe në mungesë të ligjit ata do të duhet të përshtatin veprimet e tyre dhe t'i vendosin ato mbi interesat personale dhe në dobi të së mirës së përbashkët.

#### **NENI 19.- MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE**

Noterët duhet të favorizojë zhvillimin, tregtinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare nëpërmjet njohjes së gjuhëve dhe ligjet e shteteve të tjera dhe pjesëmarrjen në institucionet ndërkombëtare të noterive të tyre, Unionit Ndërkombëtar të Noterëve dhe Rrjetit Botëror të Noterëve.

### **KAPITULLI III**

#### **MARRËDHËNIET E NOTERËVE ME ODAT APO SHOQATAT PROFESIONALE**

#### **NENI 20.- STRUKTURA E PAVARUR**

Ushtimi i veprimitarisë notiale ushtrohet në mënyrë personale dhe të pavarur nga çdo noter, i cili është përgjegjës në mënyrë individuale.

Në rast të ushtrimit të përbashkët të veprimitarisë notiale, pa cenuar përgjegjësinë personale të noterit, noterët e tjerë me veprimitari të përbashkët do të jenë bashkërisht përgjegjës për kompensimin monetar të çdo dëmi të shkaktuar.

#### **NENI 21.- ANËTARËSIMI I DETYRUESHËM**

Pa cenuar pavarësinë e veprimtarisë së tyre profesionale, me qëllim të ushtrimit të funksionit të tyre, Noterët duhet të janë anëtarë të Odës Kombëtare të Noterëve ose Shoqatës profesionale, si dhe të pranojnë të i nënshtronen ekzaminimeve, inspektimeve dhe kontrolleve të bëra nga kjo organizatë nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Në mënyrë që të fillojnë me veprimtarinë e tyre, noterët duhet të janë anëtarë të Odës së Noterëve apo Shoqatës Profesionale.

**NENI 22.- DETYRAT E NOTERËVE NDAJ ODAVE NOTERIALE APO SHOQATAVE PROFESIONALE**

Noterët duhet të përshtatin sjelljen e tyre profesionale me rregullat e Odës, në bazë të prerogativave të tyre, si dhe të ofrojnë bashkëpunim kur është e nevojshme.

Gjithashtu, duhet të përbahen nga marrja e iniciativave apo veprimeve personale me autoritetet publike, veprime të cilat do të ndikonin në vendimet e Odave.

**NENI 23.- PUNËT DHE DETYRAT E CAKTUARA.**

Noterët duhet të pranojnë funksionet për të cilat janë propozuar apo zgjedhur në Odat e tyre.

Noterët kanë për detyrë të marrin pjesë në mënyrë aktive në të gjitha aktivitetet e Odave apo shoqatave profesionale, si dhe të përbushin detyrat të cilat u janë caktuar duke i kushtuar kohën e nevojshme dhe duke përdorur mjetet e nevojshme për përbushjen e këtyre detyrave në mënyrë efikase.

Noterët duhet të informojnë trupat qeverisës të Odave të tyre, apo Shoqatave Profesionale në lidhje me çdo fakt ose akt që rrezikon interesat e profesionit, apo ngjarje tjeter që mund, në ndonjë mënyrë, të dëmtojë integritetin dhe organizimin hierarkik të odave apo shoqatave profesionale.

**NENI 24.- FUNKSIONET DREJTUESE TË ODAVE APO SHOQATAVE, KËSHILLI I LARTË I NOTERËVE**

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, anëtarët e trupave qeverisës të Odave apo Shoqatave Profesionale janë të obliguar të veprojnë në përputhje me rregullat e maturisë, drejtësisë dhe barazisë me qëllim të mbajtjes së etikës dhe dinjitetit të profesionit, ushtrimit efikas të funksionit të tyre dhe respektimit të të drejtave të individëve.

Ata ushtronjnë kompetencat e tyre disiplinore në përputhje me dispozitat ligjore, me përpikërinë dhe vendosmërinë e duhur për funksionet e tyre dhe shërbimin për të cilin janë caktuar, ndërsa të kuptuarit se gabimet e bëra nuk mund të pengojnë apo kufizojnë detyrën e integritetit të nevojshëm në ushtrimin e funksionit të tyre.

Organet qeverisëse të Odës Kombëtare të Noterëve (Këshilli i Lartë i Noterëve), që grupojnë Odat e ndryshme lokale dhe përfaqësojnë interesat e të gjithë Notariatit kombëtar, janë të obliguara t'i respektojnë veçoritë dhe nevojat e secilës Odë.

Zyrtarët e organeve notoriale të lartpërmendur, vendosin mekanizmat e duhur për të inkurajuar kolegët që të angazhohen në detyrat drejtuese si dhe të nxitin pjesëmarrjen e të gjithë noterëve të cilët janë anëtarë, në detyra dhe aktivitete të ndryshme që do të zhvillohen.

**NENI 25.- FINANCIMI I ODAVE APO SHOQATAVE TË NOTERËVE**

Noterët duhet të kontribuojnë në financimin e Odave apo Shoqatave të Noterëve në përputhje me Ligjet si dhe rregullat dhe vendimet e Shoqatave.

#### **NENI 26.- MBIKËQYRJA DHE INSPEKTIMI I VEPRIMEVE TË NOTERËVE**

Qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo përmes Odave dhe Shoqatave të Noterëve, Shteti posedon fuqinë që të ekzaminoj, kontrolloj, inspektoj dhe sanksionoj aktivitetet noteriele, të cilat do të vihen nën mbrojtjen e Gjykatave.

Shkeljet dhe sanksionet do të përcaktohen në mënyrë ligjore, nën parimi “*nulla poena sine lege*”.

Ligji rregullon procedurat e inspektimit dhe sanksioneve, si dhe ankesat kundër vendimeve të organeve noteriele që do të dorëzohen në Ministrinë e Drejtësisë.

Ankesat kundër vendimeve të Ministrisë së Drejtësisë, që i japid fund procedurave administrative, dorëzohen në Gjykata.

#### **NENI 27.- PAJTIMI, PËRKRAHJA, SOLIDARITETI**

Organet qeverisëse të Odave dhe Shoqatave të Noterëve shhangin, për aq sa është e mundur, çfarëdo mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve të tyre si dhe promovojnë ndërmjetësimin dhe pajtimin mes tyre, përmes krijimit të një mjedisi të mirë të mirëkuptimit dhe harmonisë në mesin e Noterëve anëtarë.

Në veçanti, ata do të ndihmojnë dhe përkrahin Noterët e rinj në ushtrimin efikas të funksionit të tyre.

Gjithashtu, ata rregullojnë mjetet dhe mekanizmat e solidaritetit, me qëllim që përbushja e funksionit të tyre do t'i mundësojë Noterëve të kenë një jetë të denjë gjatë karrierës së tyre dhe pas daljes në pension.

#### **NENI 28.- NUMRI I NOTERËVE. KOMPETENCA TERRITORIALE. VENDI I USHTRIMIT TË FUNKSIONIT**

Numri i noterëve rregullohet me ligj (numerus regulatus) me qëllim që të përshtatet në mënyrë adekuate me ofrimin e shërbimit.

Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, kompetenca e noterëve është territoriale.

Aktiviteti i noterëve ushtrohet në zyrën noteriele.

Zyrat sekondare nuk do autorizohen, me përashtim të rasteve ku nevoja për shërbim publik e bën të nevojshme një gjë të tillë për shkak të distancës, në përputhje me kompetencën noteriele.

Kryerja e aktiviteteve jashtë zyrës së noterit autorizohet në rastet kur personi i cili kërkon shërbim notieral nuk është në gjendje të lëvizë, ose për shkak të autoritetit publik që duhet të hartojoj aktin notieral.

Në të kundërt, vërtetimi i aktit të noterizuar jashtë mjediseve të zyrës noteriele kërkon pëlqimin eksplicit të të gjitha palëve të përfshira në akt.

E gjitha kjo pa shkelur njoftimet dhe kërkesat që noterët duhet të bëjnë jashtë praktikave të tyre.

## **NENI 29.- REKLAMIMI, PËRMBAJTJA DHE KUFIJTË**

Reklamimi i aktiviteteve të noterive dhe shpërndarja e parimeve dhe përfitimeve që rrjedhin nga një sistem notarial i tipit latin do të promovohen vetëm në mënyrë institucionale nga shoqatat profesionale.

Reklamimi, që bëhet në mënyrë individuale nga noterët, është kombinim i nevojës për informata për të cilat publiku gëzon të drejtën, dhe ndalimit të përdorimit të procedurave tregtare që synojnë "térheqjen e klientëve".

Në adresimet publike, apo në ndonjë mjet tjeter të komunikimit, noterët duhet të marrin masat e nevojshme për të shhangur Reklamimi personal.

Reklamimi informues i noterëve pranohet në përputhje me këtë Kod, vetëm nëse:

a).- Tregon emrin, kualifikimet profesionale dhe akademike, si dhe specializimet e noterit; vendin në të cilin ushtron funksionet; numrin e telefonit dhe postën elektronike/e-mail.

b).- Është bërë me qëllim që të komunikohet ndryshimi i vendbanimit profesional në publikimet ligjore dhe notariale.

c).- Është gjetur në shqyrtime dhe publikime teknike, në të cilin mund të përfshihen vetëm informatat e specifikuara në paragrafin a) më sipër.

Mos-përmbushja e këtyre kritere konsiderohet formë e shkeljes së etikës.

Plakat profesionale, të vendosura në hyrje të ndërtesave në të cilat zhvillohen praktikat notariale, nuk mund të tejkalojnë madhësinë e përcaktuar nga ligji apo Odat ose Shoqatat e Noterëve.

Shenjat, përfshirë dhe shenjat neon, në fasadat e ndërtesës, që reklamojnë një praktikë apo aktivitet notarial janë të ndaluara.

Cdo reklamim i noterëve, në formë të propagandës tregtare përmes medias është i ndaluar.

## **NENI 30.- BURIMET MATERIALE DHE NJERËZORE. ORGANIZIMI**

Praktikat notariale organizohen në mënyrë të tillë që të sigurohet funksionimi i rregullt dhe efikas, përmes përdorimit të burimeve adekuate njerëzore, materiale dhe teknologjike.

Noterët duhet të ushtrojnë funksionin e tyre në praktikat e tyre notariale në mënyrë që të sigurohet disponueshmëria e shërbimit, përmes ofrimit të vazhdimësisë dhe përshtatshmërisë së orarit të punës me nevojat e përdoruesve të shërbimeve.

Arkivat dhe dokumentet e noterizuara duhet të ruhen në kushte të përsosura, përmes klasifikimit elektronik dhe material, si dhe metodave të mirëmbajtjes, rrjedhimisht duke siguruar ruajtjen dhe rikthimin e lehtë të informatave.

Pajtueshmëria e praktikës notariale duhet të jetë e plotë dhe e saktë, dhe të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, rrjedhimisht duke mundësuar që në çdo moment të dihet shuma e përgjithshme e depozituar nga noterët, bilanci dhe rezultatet e aktivitetit notarial.

Noterët nuk mund të shfrytëzojnë për interesa të tyre personale shumat e depozituara nga përdoruesit e shërbimeve për aktivitetet të cilat u janë besuar atyre.

### **NENI 31.- MUNGESA E NOTERIT**

Sic përcaktohet në nenin 8, Noterët mund të marrin pushim nga praktikat e tyre në rastet e parashikuara me Ligj, duke siguruar se shërbimi do të vazhdojë të ofrohet në mënyrë të përshtatshme .

Ligji do të rregullojë periudhat në të cilat Noterët mund të marrin pushim nga praktikat e tyre.

### **NENI 32.- PËRKUSHTIMI PROFESIONAL. PËRGJEGJËSIA CIVILE, PENALE DHE DISIPLINORE.**

Noterët përmbushin aktivitetet e tyre me përkushtim të një profesionisti të shkëlqyer dhe marrin përgjegjësi civile për çfarëdo dëmi apo dëmtimi të shkaktuar qoftë nga sjelljet e pahijshme apo neglizhenca.

Aktivitetet e tyre garantohen në bazë të rregullave të përcaktuara me Ligj apo Odat ose Shoqatat e Noterëve. Një garanci e tillë është kushti paraprak për fillimin e veprimtarisë së tyre.

Ligji i përcakton rastet në të cilat mund të shkaktohet përgjegjësi penale si rezultat i veprimeve mashtruese, pakujdesia ose pamaturia profesionale e noterëve.

Përgjegjësia disiplinore e Noterëve është rezultat i mos-përmbushjes së rregullave notierale dhe veprimeve në kundërshtim me dinjitetin e funksionit të tij ose rregullat e këtij Kodi.

### **NENI 33.- SOLIDARITETI FINANCIAR**

Noterët përfitojnë nga sistemi i solidaritetit finanziar.

Në mungesë të rregulloreve në këtë drejtim, Odat apo Shoqatat e Noterëve organizojnë sistemin e tyre të solidaritetit notarial.

Solidariteti notarial ofron mbështetje financiare për praktikat notierale në rastet kur performance financiare e këtyre të fundit nuk është e mjaftueshme për të mbuluar kostot e shërbimeve të nevojshme notierale.

Gjithashtu, solidariteti notarial ofron mbështetje financiare për Noterët, si dhe për familjet e tyre, në rast të vdekjes, sëmundjes, paaftësisë si dhe daljes në pension.

Fondet notierale mirëmbajnë një strukturë të investimeve financiare, të përshtatur për rreziqet e garantuara.

## KAPITULLI IV

### MARRËDHËNIET E NOTERËVE ME NOTERËT E TJERË, PUNONJËSIT DHE PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE

#### Seksioni 1.- Marrëdhëniet me Noterët e tjerë

##### NENI 34.- MARRËDHËNIET ME NOTERËT E TJERË.

Marrëdhëniet e Noterit me kolegët bashkëpunëtorë ndërtohen në baza kolegjiale.

Noteri duhet t'i konsiderojë Noterët e tjerë si kolegë, të bashkuar në arritjen e një objektivi të përbashkët, përkatësisht në ushtrimin efikas të profesionit, dhe jo si konkurrentë.

Sjellja e një Noteri kundrejt Noterëve të tjerë duhet të jetë e saktë, si dhe të ketë për qëllim bashkëpunimin dhe solidaritetin, duke nxitur shkëmbimin e mbështetjes, shërbimeve dhe këshillave.

Noteri nuk diskrediton Noterët e tjerë. Gabimet shkencore ose teknike, apo fajet deontologjike të kryera nga një Noter tjetër duhet të komunikohen në Oda apo Shoqata, duke pasur parasysh ndërmarrjen e ndonjë rasti disiplinor apo procedure në Gjykatë.

Dallimet në mendimet mes Noterëve rregullohen, për aq sa është e mundur, nga gjykata. Për këtë qëllim, Noterët mund të kërkojnë, kurdo që është e nevojshme, ndërhyrjen e Odës ose Shoqatës së Noterëve.

##### NENI 35.- ZGJEDHJA E LIRË E NOTERIT

Shërbimi Notarial konsideron të drejtën e qytetarëve në zgjedhjen e lirë të noterit si të drejtë themelore, me përjashtim të rasteve kur noteri përcaktohet me ligj.

Noterët duhet që gjithmonë të respektojnë këtë të drejtë.

Noterët duhet të shmangin "tërheqjen e klientëve" përmes ofrimit të tarifave të zvogëluara, koncesioneve, dhuratave ose uljeve, ose përmes angazhimit në veprim tjetër të ngjashëm që është në kundërshtim me dinjitetin dhe pavarësinë e Funksionit Notarial.

##### NENI 36.- NDRYSHIMI I DOSJES NOTERIALE

Në mënyrë që dosja aktuale të bartet nga një noter tek tjetri, përdoruesi i shërbimit duhet të dorëzojë një kërkësë eksplikite të heqjes dorë dhe të paguajë tarifat për shkak të Noterit që ishte i ngarkuar më parë në dosje.

Noteri i emëruar rishtas, do të duhet të kërkojë shlyerjen e çdo takse që nuk është paguar nga noteri që ishte i ngarkuar më parë në dosje, dhe shlyerjen e tyre nga përdoruesi i shërbimit.

Në qoftë se përdoruesi i shërbimit nuk pajtohet me tarifat e kërkua, nga ai do të kerkohet që ta referojë çështjen, me qëllim të zgjidhjes së saj, në Odën ose Shoqatën e Noterëve.

Në qoftë se përdoruesi i shërbimit nuk dëshiron të paguajë taksat, pasi të ketë njofuar në mënyrë të rregullt Noterin e mëparshëm, Noteri i ri mund të vazhdojë të trajtojë dosjen deri sa çështja të zgjidhet, pa cenuar njoftimin e refuzimit të përdoruesit të shërbimit në Odë ose Shoqatë.

#### **NENI 37.- ÇËSHTJET E TRAJTUARA NGA MË SHUMË SE NJË NOTER, QOFTË KOMBËTARE, QOFTË TË HUAJA**

Në rast të bashkëpunimit të disa Noterëve në një çështje të vetme, këta të fundit duhet së bashku të kërkojnë zgjidhjen më të mirë, duke garantuar interesat e të gjitha palëve, si dhe duke respektuar të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Noterët anëtarë të UINL-së bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë përvojat me qëllim të përmirësimit të shërbimit të vazhdueshëm Notarial, si për qytetarët ashtu edhe për ndërmarrjet.

Rrjeti Botëror i Noterëve (RrBN) do të jetë përgjegjës në asistimin e Noterëve të përfshirë në transaksionet ndërkombëtare, në përputhje me rregullat e UINL-së.

#### **NENI 38.- PRAKTIKAT ME DISA NOTERË**

Prezenca e disa Noterëve në një praktikë Notieriale nuk duhet të pengojë zgjedhjen e lirë të Noterit nga përdoruesi i shërbimit, dhe do të jetë e mundur vetëm kur kjo e drejtë garantohet në lokacionin e njëjtë.

Grupimi i disa noterëve, që krijohet në përputhje me ligjet e secilit Shtet, nuk duhet të pengojë përgjegjësinë e përbashkët të të gjithë noterëve të grupuar për çfarëdo fakti ose mosveprimi të Noterëve dhe punonjësve në praktikë.

#### **NENI 39.- BASHKËPUNIMI ME PROFESIONISTË TË TJERË**

Bashkëpunimi i noterit me profesionistë të tjere përveç noterëve (për shembull në kompanitë ndër-profesionale), kur lejohet me ligj, garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e Noterit.

#### **NENI 40.- NDIHMA NDAJ NOTERËVE TË SËMURË OSE QË MUNGOJNË**

Zëvendësimi i një noteri të sëmurë apo i cili mungon bëhet duke garantuar përkushtim të njëjtë dhe profesionalizëm të përhershëm të praktikës, si dhe respektimit të përdoruesve të shërbimeve dhe punonjësve të noterit të zëvendësuar.

Pagesa për zëvendësim bazohet në marrëveshjet ndërmjet palëve në fjalë. Në mungesë të marrëveshjeve, pagesat do të rregullohen në përputhje me përdorimet dhe rregullat e vendit, ndërsa në rast të mungesës të tyre, përmes kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga Oda apo Shoqata e Noterëve.

**- Seksioni 2.- Marrëdhëniet me punëtorë, noterët e ardhshëm dhe personeli  
i zyrës**

**NENI 41.- ORGANIZIMI I PRAKTIKËS NOTERIALE**

Organizimi i praktikës noteriele do të përcaktohet nga Noteri, i cili duhet të përmbush kërkosat në aspektin e burimeve materiale dhe njerëzore, të vendosura nga shoqata apo Oda dhe ligji, duke siguruar trajtim të mjaftueshëm dhe dinjitoz, kushte të punës dhe pagesë për ushtrimin e profesionit nga punëtorët ose bashkëpunëtorët e tij.

Zyra notierale duhet të jetë e pajisur me teknologji të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të ushtruar funksionin, në përputhje me organizimin shtetëror dhe shërbimin publik që ofrohet.

**NENI 42.- BURIMET NJERËZORE**

Noteri duhet të informojë punëtorët dhe bashkë-punëtorët e tij dhe të kërkojë pajtueshmëri me rregullat deontologjike dhe rregullat e tjera që rregullojnë ushtrimin e profesionit. Ai do mbahet përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e punëtorëve dhe bashkë-punëtorëve në fjalë.

Noteri duhet të shkarkoj cilindo që mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt nuk i respekton rregullat e këtij kodit.

**NENI 43.- ARSIMI I VAZHDUESHËM, CILËSIA**

Noteri duhet të inkurajojë dhe mbikëqyrë përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit përmes arsimimit të vazhdueshëm të punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve të tij duke bërë që ata të marrin pjesë në kurset e trajnimit teknik dhe kurset për përmirësimin e njohurisë dhe praktikës ligjore me qëllim të arritjes së cilësisë në ushtrimin e funksionit notieral.

**NENI 44.- AKTIVITETET JASHTË-NOTERIALE PËR  
PUNËTORËT**

Nëse ligji e lejon që punëtorët e noterisë të angazhohen në aktivitete jashtë—noteriele, këto të fundit duhet të jenë në pajtueshmëri dhe jo në konkurrencë me aktivitetet notierale dhe në asnjë rast nuk duhet të çojnë deri tek përfitimet e drejtpërdrejta ose indirekte për noterin.

**NENI 45.- KANDIDATËT PËR NOTER**

Kandidatët dhe noterët në trajnim duhet të mësojnë dhe të fitojnë njohuri jo vetëm për ligjin dhe teknologjinë por edhe për mënyrën se si është dhe si “duhet të jetë” në profesion dhe shërbimin notieral.

Ata do të trajnohen me respekt dhe të mbështeten nga noterët përgjegjës për trajnimin e tyre.

### Seksioni 3.- Marrëdhëniet me përdoruesit e shërbimeve

#### NENI 46.- MARRËDHËNIET E JASHTME

Noterët duhet gjithmonë të ndjekin të mirën e përbashkët.

Ata duhet të veprojnë në mënyrë të paanshme dhe të pavarur në të gjitha aspektet e profesionit të tyre, duke shmangur çfarëdo ndikimi të jashtëm mbi aktivitetin e tyre dhe çfarëdo forme të diskriminimit ndaj përdoruesve të shërbimit.

Ata duhet ti kushtojnë rëndësi të veçantë palës e cila ka nevojë për më shumë informacione, duke plotësuar çfarëdo pabarazie në njohuri, duke ofruar në mënyrë aktive këshilla dhe mendime profesionale, dhe duke mbajtur një pozicion të balancuar që synon ruajtjen e ligjshmërisë së aktit notarial apo transaksionit, efektin e plotë të dokumentit të vërtetuar si dhe sigurinë dhe paqen e palëve.

Ata duhet të informojnë përdoruesit e shërbimeve në mënyrë të qartë dhe profesionale për mjetet legitime që të arrihen qëllimet e ligjshme që kërkohen dhe pasojat e veprimeve ose transaksioneve të planifikuara, dhe i paralajmëron për efektet e pafavorshme, nëse ata insistojnë me kërkesat e tyre.

#### NENI 47.- MARRËDHËNIET ME DOSJET

Noteri duhet gjithmonë të bëj përpjekje maksimale dhe të merret me aktet dhe transaktionet të cilat, për shkak të natyrës së tyre, ndikojnë në jetën personale të njerëzve.

#### NENI 48.- E DREJTA E KONFIDENCIALITETIT DHE SEKRETIT PROFESIONAL

Noterët duhet të respektojnë të drejtën e konfidencialitetit të personave. Ata kanë të drejtë dhe detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional dhe konfidencialitetit, me qëllim të sigurimit të së mirës së përbashkët dhe interesit të përgjithshëm të shoqërisë.

Këto detyra kanë të bëjnë si me noterët ashtu edhe me punëtorët dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Kjo përfshinë edhe dokumentet në regjistra dhe arkiva të tjera notarial si dhe të gjitha të dhënat e ruajtura nga noterët dhe çfarëdo informate të dhënë në mënyrë verbale.

Fshehtësia duhet të ruhet veçanërisht në dokumentet elektronike, duke përdorur procedurat e sigurisë dhe mjetet e përshtatshme për sigurimin e ruajtjes së tyre dhe konsultimit në të ardhmen duke shmangur kopjimin, humbjen, shpërndarjen dhe publikimin e tyre.

Sekreti profesional nuk është absolut dhe është në varësi të interesit të përgjithshëm dhe të së mirës së përbashkët, pasi që noterëve do u duhet të zbulojnë përbajtjen e arkivave të tyre në procedurat penale ose kur kërkohet nga ligji.

Noterët do të marrin parasysh të drejtat apo interesat legitime, si një arsy e drejtë, e palëve që kërkojnë qasje në arkivat e tyre, duke pasur kujdes, maturi dhe vëmendje, sidomos kur aktet ose dokumentet u njohin apo u atribuojnë atyre të drejta. Noterët duhet të respektojnë ato në mënyrë sa më të përshtatshme që të jetë e mundur, duke

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*  
paraqitur kopje të plota apo të pjesshme të veprimeve ose dokumenteve në fjalë.

#### **NENI 49.- DETYRA E ABSTENIMIT**

Ushtimi i funksionit notarial është i detyrueshëm për noterët, duke përjashtuar raste kur ata detyrohen të refuzojnë shërbimet e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit.

Përveç rasteve të përshkruara, noterëve duhet të përbahen nga veprimi kur për shkak të lidhjeve personale apo familjare apo interesave të drejtpërdrejta ose të tërthorta, një veprim mund të çojë në atribuimin e të drejtave në favorin e tyre ose në favor të familjeve të tyre deri në shkallën e katërt farefisnore.

Ata duhet të përbahen nga hartimi i akteve në kundërshtim me ligjin ose standartet e pranuara të sjelljes së mirë apo të mirëbesimit.

#### **NENI 50.- PËRPUTHSHMËRIA**

Funksioni notarial është kompatibil me aktivitetet e këshillit gjyqësor, si shërbimet e mësimdhënies, ndërmjetësimit, arbitrazhit, shërbimet konsullore dhe aktivitetet e tjera gjyqësore jo-kontestimore që respektojnë pavarësinë dhe paanshmérinë e noterëve.

Aktiviteti notarial nuk përputhet me ushtrimin e aktivitetet e tregtisë, dhe aktivitetet nën juridikcionin e autoritetet gjyqësore dhe funksioneve publike.

#### **NENI 51.- TARIFAT TRANSPARENTE**

Tarifat e noterëve rregullohen me anë të tarifave të përcaktuara me ligj, apo në mungesë të tij, nga odat ose shoqatat profesionale.

Tarifat duhet të sigurojnë paanshmérinë dhe pavarësinë e shërbimit notarial, si dhe ekselencën në aspektin e cilësisë dhe qasjes së përgjithshme të qytetarëve.

Tarifat nuk duhet të mundësojnë reduktime apo ulje të tarifës që shpie në konkurrencë jo të drejtë të bazuar vetëm në çmim, në dëm të cilësisë dhe pavarësisë së shërbimit.

Tarifat notieriale duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe lehtësishët të qasshme për publikun.

Artikujt dhe shërbimet e faturuara duhet të shpjegohen qartë në faturat notieriale.

#### **NENI 52.- MBROJTJA E TË MIRËS SË PËRBASHKËT**

Shërbimi notarial duhet të kontribuojë në të mirën e përbashkët të shoqërisë, një kriter që përdoret për interpretimin e neneve të mëparshme.

## KREU V

### SISTEMI DISIPLINOR, SHKELJET DHE SANKSIONET

#### NENI.- 53.- LIGJSHMËRIA

Ky kod rregullon dhe sanksionon shkeljet deontologjike brenda profesionit, pa cenuar sanksionet për shkelje të rregullave substanciale ose rregullave të një natyre tjetër (penale, administrative) të kryer nga noterët.

Sistemi disiplinor i noterëve do të rregullohet me parimin “*nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege*”, mbi bazën e të cilës nuk do të zbatohet asnje sanksion, përvèç nëse shkelja është e rregulluar me ligj.

#### NENI 54.- PROCEDURA

Shkeljet e sjelljeve apo fakteve të përcaktuara në këtë kod duhet të ekzaminohen pas inicimit të procedurës nga oda ose shoqatat profesionale sipas autoritetit hierarkik të Ministrisë së Drejtësisë, ku mund të parashtrohen ankesat e ndërlidhura.

Ankesat kundër vendimeve të marra pas procedurave të brendshme mund të parashtrohen në gjykatë.

Personi në fjalë duhet të dëgjohet gjatë secilës fazë të procedurës, në përputhje me të drejtën e tij për mbrojtje dhe në bazë të supozimit të pafajësisë së tij.

#### NENI 55.- RASTET E NDËRLIDHURA ME SANKSIONET, SEANCAT DËGJIMORE

Organi drejtues i odës ose shoqatës të cilës i takon noteri mund të shqyrtojë dosjen disiplinore të rastit zyrtarisht ose mund ta bëjë këtë me kërkesën e njërisë nga palët, nëse fakti i raportuar është në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë kod.

Faza hetuese do të hapet pasi të jenë caktuar një ose më shumë noterë përgjegjës për të përbushur funksionet e hetuesit dhe sekretarit të shkresës së lëndës.

Në fund të kësaj faze të hetimit, noteri hetues duhet t'i përcjell konkluzionet e tij tek oda që duhet të marrë një vendim.

Kundër vendimit të Odës mund të parashtrohet ankesë në Ministrinë e Drejtësisë, vendim i të cilës do të jetë përfundimtar. Ankesa kundër vendimit të Ministrisë mund të parashtrohet vetëm në gjykatë.

Ligji cakton afatet kohore për secilën fazë të procedurës.

#### NENI 56.- SHKELJET

Mos përbushja e detyrave të parapara me Ligjin mbi Noterinë, gjatë ushtrimit të funksioneve të noterit është shkelje deontologjike e sanksionuar me këtë kod.

Sipas rregullave të këtij Kodi, në vijim janë shkeljet që konsiderohen si deontologjike pavarësisht nëse ato janë të përfshira ose jo në rregulloret notieriale:

1. Mungesa e Noterit kur duhet të autorizohet apo të nënshkruhet një akt

2. Ndryshimi i datës apo përbajtjeve dhe vërtetësisë së dokumentit.
3. Vërtetimi i dokumenteve jashtë kompetencës territoriale të Noterit
4. Nënshkrimi i akteve autentike apo dokumenteve të noterizuara në kundërshtim me ligjin, apo përfshirje në shmangie mashtruese të ligjit apo abuzim i hapur i së drejtës.
5. Mos-pagesa e tatimeve nga noteri.
6. Përfshirja në rastet e pa-pajtueshmërisë të parapara me ligj.
7. Shkelja e të drejtës për konfidencialitet ose fshehtësisë profesionale.
8. Përdorimi i fondeve për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë marrë.
9. Pranimi i korruptimit, bashkëpunim në veprimitari të paligjshme, pastrim të parave, terrorizëm.
10. Lidhjet financiare me një nga palët, duke nënkuptuar kështu humbje të pavarësisë dhe paanësisë.
11. Mos-dhënia e ndihmës, këshillës apo opinionit profesional për palën apo klientin më të cenueshëm.
12. Mos-shpjegimi i dispozitave të përgjithshme të kontratës apo natyrës abuzive të dispozitës të imponuar nga njëra prej palëve.
13. Mos-respektim i të drejtave të njeriut apo përpilim i aktit në kundërshtim me dinjitetin njerëzor.
14. Shkelje e rregullave lidhur me mjedisin, planifikimin urban, ujin, ajrin, brigjet, bujqësinë, pyjet dhe minierat.
15. Mos konsultim paraprak i titujve, regjistrave dhe dokumenteve të mëparshme.
16. Humbja e pavarësisë apo paanësisë në ushtrimin e detyrës së Noterit dhe në përpilimin apo autorizimin e akteve.
17. Mosrespektimi i të drejtës së qytetarit për zgjedhjen e lirë të Noterit.
18. Mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar nga ana e përdoruesit të shërbimit.
19. Mos-respektim i detyrës për abstenim në rastet e parapara me Ligj.
20. Mos-respektim apo “joshje e klientëve” dhe punonjësve të noterëve të tjerë.
21. Mos-lëshim i faturave të detajuara për shpenzimet apo të tarifës.
22. Faturimi më i ulët se sa normat e përcaktuara me ligj, uljet, ofrimi i dhuratave apo përqindjeve.
23. Mos-përputhshmëria mes aktiveve (aseteve) dhe pasiveve (detyrimeve) me gjendjen e bilancit të noterisë si dhe mungesa e mundësisë për kontrollimin e normave dhe depozitave të aplikuara si dhe pagesave fillestare të kryera nga përdoruesit e shërbimeve.
24. Shkelja e rregullave dhe udhëzimeve të aprovuara nga Oda apo Shoqata e Noterëve dhe/ose Ministria e Drejtësisë.

25. Braktisja e shërbimeve të noterisë pa arsyetim dhe pa autorizim paraprak nga Oda apo Shoqata e Noterisë.
26. Mos-respektim i rregullave të brendshme, qarkoreve dhe rregullave të Odës apo Shoqatës së Noterisë, apo veprimet në kundërshtim me këtë të fundit apo me vendime të tyre, natyra e të cilave do të varet nga rregullat apo udhëzimet e shkelura.
27. Mos pagesa e tarifës së anëtarësisë tek Oda apo Shoqata e Noterisë dhe/ose kontributete tek institucionet e sigurimeve sociale notieriale.
28. Parandalimi, vonesa ose pengimi i inspektiveve dhe kontrolleve të praktikave notieriale të kryera nga ana e Odave apo Shoqatave të Noterisë apo organeve të inspektimit.
29. Pengesa apo vonesa të lidhura me raste disiplinore.
30. Mos-dërgimi i akteve për regjistrim në regjistra, nëse kjo është e detyrueshme me ligj apo kur noteri e ka marrë përsipër të bëjë këtë kundrejt përdoruesit të shërbimit
31. Veprimet e kryera jashtë praktikës notieriale në raste e ndaluara me ligj.
32. Mos përbushje e detyrave të caktuara nga ana e Odave.
33. Mungesa e bashkëpunimit apo ndihmesës së kolegëve të tjerë në rast të sëmundjes apo paaftësisë.
34. Reklamimi i ndaluar me këtë Kod.
35. Burime të pamjaftueshme teknologjike apo njerëzore për të siguruar shërbime notieriale.
36. Refuzimi i funksionit pa ndonjë shkak të arsyetuar ligjërisht, vonesa të pa arsyeshme apo refuzim i rasteve të caktuara.
37. Mos përbushja e detyrës për edukim të vazhdueshëm të Noterit, punëtorëve si dhe bashkëpunëtorëve të tij.
38. Mungesa e vëmendjes dhe mbështetjes së kandidatëve për noter.
39. Pagesë e padrejtë, në kundërshtim me dinjitetin e punonjësve dhe bashkëpunëtorëve.

#### **NENI 57.- KLASIFIKIMI I SHKELJEVE**

Shkeljet mund të jenë të thjeshta, të rënda apo shumë të rënda

Shkeljet e lehta do të sanksionohen me vërejtje apo me vërejtje dhe gjobë.

Shkeljet e rënda do të sanksionohen me vërejtje dhe gjobë, apo me vërejtje, gjobë dhe suspendim të përkohshëm nga shërbimet.

Shkeljet shumë të rënda do të sanksionohen me vërejtje, gjobë dhe suspendim të përkohshëm nga shërbimi, apo me largim nga organi i noterisë, si shtesë edhe sanksion

*Dokument i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Noterive Anëtare në Lima, më datë 8 tetor 2013*  
monetar përkatës.

Çështja disiplinore apo kompensim i dëmit të shkaktuar nuk do të jetë në përputhje me procedurën për përgjegjësi civile ose penale të noterit para një gjykatës.

Sa i përket përjashtimit, do të kërkohet vendim i organit më të lartë në hierarki të Noterisë.

#### **NENI 58.- KUALIFIKIMI I SANKSIONEVE**

Përsëritja e sjelljes së dënueshme përbën shkelje të rëndë.

#### **NENI 59.- KLASIFIKIMI I SANKSIONEVE**

Shkeljet sipas Nenit 56 detyrimisht duhet të sanksionohen si në vijim:

##### **1. SANKSIONE SHUMË TË RËNDA**

Të përfshirë numrat prej 1deri 9

##### **2.- SANKSIONET E RËNDA**

Të përfshirë numrat nga 10 deri 30.

##### **3.- SANKSIONET E LEHTA**

Të përfshirë numrat nga 31 deri 39.

Shkelja numër 26 do të konsiderohet e rëndë ose e lehtë varësisht nga rregulla e shkelur.

#### **NENI 60.- RRGULLORE PËR PROCEDURËN E SANKSIONEVE**

Në mungesë të ligjeve, Odat apo Shoqatat e Noterisë do të hartojnë rregulloren ku përcaktohen procedurat e zbatimit të sanksioneve, duke përcaktuar shumën e sanksioneve përkatëse monetare dhe kohëzgjatjen e pezullimit të përkohshëm nga shërbimi.

#### **NENI 61.- DISPOZITAT E PËRKOHSHME**

Dispozitat e këtij Kodi do të janë të aplikueshme pas aprovimit nga ana e Odës apo Shoqatës.

#### **NENI 62. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Shkeljet e përfshira në këtë Kod kërkojnë hartimin e një ligji në mënyrë që të zbatohen, përfshihen dhe detajohen më mirë në këtë të fundit, përveç nëse ky Kod miratohet si ligj.

Me këtë Kod shfuqizohet Kodi i etikës së noterëve dhe i sjelljes profesionale të Odës së Noterëve, i miratuar me 14 Prill 2012, nga Kuvendi i Odës së Noterëve.

Ky Kod hyn në fuqi prej datës 15 Prill 2017.

Miratuar nga Kuvendi i Odës së Noterëve me datë 15.04.2017

Arbena Shehu  
Kryetare e Odës së Noterëve

